

ÇËSHËTJA E IDENTITETIT NË EPOKËN DIGJITALE**ПРАШАЊЕТО НА ИДЕНТИТЕТОТ ВО ДИГИТАЛНОТО ДОБА****THE QUESTION OF IDENTITY IN THE DIGITAL ERA****Abstract**

In an age defined by constant digital connectivity, the construction and perception of identity have undergone profound transformations. This paper explores the evolving nature of identity in the digital era, beginning with a conceptual definition rooted in sociological and psychological theory. The rise of social media platforms-spaces shaped by visibility, interaction, and self-curation-has introduced a new context for self-presentation, challenging traditional understandings of authenticity, stability, and personal coherence. As digital spaces increasingly mediate everyday life, they foster a dynamic interplay between the real and the representational. These platforms offer both opportunities for self-expression and risks of alienation, as users shift between multiple roles and curated versions of themselves. Communication, once a vehicle for genuine interpersonal exchange, is increasingly instrumentalized as a tool for image management, where every post or message becomes a calculated gesture. This shift blurs the line between being and appearing, raising critical questions about the nature of the self in environments defined by constant exposure and surveillance. The paper reflects on the emerging challenges of identity in this mediated reality-questioning whether we are advancing toward a culture of surface over substance, performance over presence, and what this implies for the future of human subjectivity, agency, and psychological well-being in the digital age.

Keywords: *identity, digital era, social media, self-presentation, authenticity, identity construction*

¹ MA, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve.
Email: fjollazllatku@gmail.com

Hyrje

Në epokën digjitale, çështja e identitetit merr një rëndësi të re dhe tejet thelbësore, duke u shndërruar kështu në një ndër temat më të diskutuara në shkencat shoqërore. Shfaqja dhe zhvillimi i rrjeteve sociale, ndërthurja e realitetit fizik me atë virtual, si dhe teknologjitë e shumta që janë bërë pjesë e jetës sonë të përditshme, kanë krijuar një peizazh të ri për ndërtimin, paraqitjen dhe transformimin e vetes. Pa dyshim që kjo epokë karakterizohet nga një hapësirë të gjerë vetëprezantimi, ku individit tashmë nuk kufizohet nga normat tradicionale, por ka mundësinë që të ndërtojë identitete të shumta, të përshatura sipas konteksteve dhe dëshirave të tij.

Në këtë drejtim, duhet vënë në pah edhe zhvillimin e vetë konceptit të identitetit. Në kohët moderne, identiteti nuk është më vetëm një kategori statike. Përkundrazi, ai shfaqet si një konstrukt fluid, i ndjeshëm ndaj ndikimeve kulturore, politike dhe teknologjike. Koncepte si “të jem ai që dua të jem”, vetëdefinimi i lirë, liberalizmi kulturor dhe pluralizmi identitar janë bërë një pjesë e përditshmërisë, duke vënë në pikëpyetje kufijtë e dikurshëm të racës, gjinisë, fesë, rolit shoqëror apo përkatësisë ideologjike. Siç e thotë Zygmunt Bauman² me konceptin e “identitetit fluid”- në një shoqëri ku strukturat janë të përkohshme dhe marrëdhëniet janë të pasigurta, identiteti bëhet gjithnjë e më i brishtë.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të eksplorojë mënyrën se si identiteti i individit formohet, menaxhohet dhe transformohet në kontekstin e epokës digjitale, me theks të veçantë në ndikimin e rrjeteve sociale si hapësira të reja për vetëprezantim dhe ndërtim të vetes. Kërkimi synon të analizojë se si konceptet tradicionale të identitetit (i qëndrueshëm, koherent, i rrënjësuar në përkatësi sociale dhe kulturore) janë sfiduar nga mundësitë e pafundme për vetëformësim, që ofrohen nga teknologjia dhe mjediset virtuale. Përmes një qasjeje teorike-krahasuese, hulumtimi ndërthur perspektivat sociologjike, psikologjike dhe kulturore për të shqyrtuar se deri në çfarë mase identiteti i sotëm është bërë një projekt i ri i kohës.

Pyetjet kryesore të këtij hulumtimi janë: Si e përjetojnë dhe e ndërtojnë individët identitetin e tyre nëpërmjet platformave digjitale? Cilat janë format dominuese të vetëprezantimit në rrjete sociale dhe çfarë thonë ato për identitetin modern? A ndodhemi përballë një sipërfaqësimi të identitetit, ku të dukurit është më e rëndësishme se të qenët? Si ndikon ndërveprimi i vazhdueshëm me teknologjinë në ndjenjën e vërtetësisë dhe koherencës personale? Në thelb, ky hulumtim synon të kuptojë pozicionin aktual të subjektit modern përballë një bote gjithnjë e më të ndërlidhur digjitalisht, duke vënë në dukje sfidat, mundësitë dhe tensionet mes “të dukurit” dhe “të qenët”. Në këtë mënyrë, ai synon të kontribuojë në debatin shkencor mbi mënyrën se si

² Bauman, Z. (2000). *Liquid Modernity*. Cambridge: Polity Press.

teknologjia nuk është vetëm ndërmjetësuese por edhe bashkëformësuese, sidomos kur i referohemi çështjes së identitetit.

Kuadri teorik i temës së identitetit në botën digjitale

Ky punim mbështetet në një analizë teorike-kritike, me fokus në kuptimin e ndërtimit të identitetit përmes kornizave sociologjike dhe psikologjike. Studiues të ndryshëm kanë trajtuar çështjen e identitetit në kontekstin e zhvillimeve teknologjike dhe rrjeteve sociale, duke ndihmuar në formësimin e kuadrit teorik për analizën e këtij fenomeni. Burimet kryesore teorike përfshijnë: teorinë e dramaturgjisë të Goffman të vitit 1959, teorinë e identitetit fluid të Bauman, qasjen poststrukturaiste ndaj vetëprezantimit të Turkle, perspektivën e Boyd për sa u përket adoleshentëve dhe botës teknologjike dhe teorinë e vetëdijes refleksive dhe të vetëmonitorimit të Giddens. Metoda do të përfshijë krahasimin ndërmjet ideve teorike dhe rasteve konkrete të përdorimit të rrjeteve sociale, me shembuj ilustrues dhe referenca nga studime ekzistuese.

Erving Goffman është një nga teoricienët themelorë në kuptimin e mënyrës se si individët paraqesin veten në kontekste sociale. Ai përdor një qasje dramaturgjike për të shpjeguar se jeta shoqërore është si një skenë, ku individët luajnë role të ndryshme përballë një audience.³ Kjo ide ka pasur ndikim të thellë në analizën e vetëprezantimit në rrjetet sociale, ku përdoruesit zgjedhin me kujdes se cilat aspekte të identitetit t'i ekspozojnë. Ai përdor metaforën e teatrit për të shpjeguar se identiteti nuk është një entitet i brendshëm i pandryshueshëm, por një sërë paraqitjesh të menaxhuara nga individit për të krijuar përshtypje të caktuara tek të tjerët.

Ndërkaq Sherry Turkle ka analizuar ndikimin e teknologjisë dhe botëve virtuale në vetëdijen dhe identitetin e individit.⁴ Ajo argumenton se interneti ofron një hapësirë eksperimentimi për identitete të shumta dhe fleksibile, ama ndërkaq e kritikon mënyrën si teknologjia ka krijuar lidhje të dobëta dhe një ndjenjë të re të vetmisë, duke problematizuar raportin ndërmjet intimitetit dhe teknologjisë. Nëse do t'i referohemi një analize empirike mbi mënyrën se si të rinjtë ndërtojnë identitetin e tyre përmes përdorimit të rrjeteve sociale, Boyd tregon se, ndryshe nga të rriturit, të rinjtë e përdorin hapësirën virtuale për të krijuar një identitet publik dhe për të marrë kontroll mbi perceptimin social të vetes. Ajo thekson rëndësinë e kontekstit social, privatësisë dhe strukturës së platformës në ndërtimin e identitetit.⁵

³ Goffman, E. (1959). *The Presentation of Self in Everyday Life*. Garden City, NY: Doubleday Anchor Books.

⁴ Turkle, S. (2011). *Alone Together: Why We Expect More from Technology and Less from Each Other*. New York: Basic Books.

⁵ Boyd, D. (2014). *It's Complicated: The Social Lives of Networked Teens*. New Haven, CT: Yale University Press.

Gjithashtu, do të ishte e rëndësishme që të definojmë dhe kohën moderne duke u bazuar te Zygmunt Bauman dhe moderniteti i tij “likuid”, i cili ofron një kuadër teorik për të kuptuar identitetin në kohët moderne si një projekt i vazhdueshëm dhe i pasigurt. Ai e përshkruan shoqërinë e sotme si të paqëndrueshme apo të lëngshme, ku individët detyrohen të rizbulojnë dhe rindërtojnë identitetin e tyre në mënyrë të vazhdueshme.⁶ Ndërkaq, Giddens shpjegon se në modernitetin reflektiv, ndërtimi i identitetit bëhet një projekt personal që kërkon vetë-monitorim dhe vendimmarrje të vazhdueshme. Kjo teori është shumë e përshtatshme për analizën e sjelljes në rrjetet sociale, ku individët janë gjithmonë të vetëdijshëm për imazhin që projektojnë.⁷

Zhvillimi historik i konceptit të identitetit dhe perspektiva psikologjike dhe sociologjike

Identiteti është një nga konceptet më themelore dhe njëkohësisht më komplekse në shkencat humane dhe sociale. Ai përfshin mënyrën se si individët e kuptojnë, e strukturojnë dhe e prezantojnë vetveten në raport me botën. Në thelb, identiteti i referohet ndjesisë së vazhdimësisë dhe koherencës personale - ndjesisë së të qenurit “unë” përgjatë kohës dhe përballë ndryshimeve të jashtme. Por kjo ndjesi nuk është e dhënë natyrshëm; ajo ndërtohet, ripërpunohet dhe ndikohet nga faktorë të shumtë individualë dhe shoqërorë.

Në psikologji, identiteti është konceptuar si një strukturë e brendshme që lidhet me ndjesinë e vetes dhe integritetit personal. Një nga figurat më të shquara të kësaj fushe Erik Erikson, e lidhi zhvillimin e identitetit me fazat e zhvillimit psikologjik. Sipas tij, formimi i identitetit është një proces që kulmon në adoleshencë, periudhë në të cilën individ ballafaqohet me krizën e “identitetit kundrejt konfuzionit të rolit”.⁸ Për Eriksonin, një identitet i qëndrueshëm është rezultat i integritetit të përvojave personale me rolet shoqërore të pranuar, identiteti është përjetimi subjektiv i një ndjenje të vazhdueshme të të qenit i njëjtë me veten dhe i njohur nga të tjerët përmes kohës. Formimi i identitetit nuk është një proces i njehershëm, por zhvillohet gjatë gjithë jetës. Në fëmijëri, identiteti nis të ndërtohet përmes identifikimit me prindërit, kulturën dhe normat që e rrethojnë individin. Gjatë adoleshencës, individ përballet me nevojën për të vendosur vetëdijen e tij në raport me pritshmëritë shoqërore dhe kulturore. Kjo është një periudhë krize dhe eksplorimi, ku formohen përkatësitë (si kombëtare, gjinore, kulturore) dhe ndjenja e autenticitetit.

⁶ Bauman, Z. (2000). *Liquid Modernity*. Cambridge: Polity Press.

⁷ Giddens, A. (1991). *Modernity and Self-Identity: Self and Society in the Late Modern Age*. Cambridge: Polity Press.

⁸ Erikson, E. H. (1968). *Identity: Youth and Crisis*. New York: W. W. Norton & Company, f. 50.

Në aspektin historik, koncepti i identitetit nuk ka qenë gjithmonë i pranishëm në formën e sotme. Në shoqëritë tradicionale, identiteti përcaktohej kryesisht nga faktorë si gjinia, përkatësia etnike, religjioni dhe statusi social. Ai ishte i trashëguar dhe i ngurtë, më shumë një kategori e përcaktuar nga tjetri sesa nga vetja. Me ardhjen e modernitetit dhe më pas postmodernitetit, identiteti nisi të shihej si një projekt i vetëdijshëm, i lëvizshëm dhe gjithnjë në zhvillim - një proces në të cilin individit ka më shumë kontroll dhe zgjedhje. Në shoqëritë moderne dhe digjitale, formimi i identitetit ndikohet nga shumë më tepër faktorë - media, rrjetet sociale, ideologjitë politike, dhe presionet kulturore për vetërealizim. Giddens e përshkruan këtë proces si një “projekt refleksiv”, ku individit duhet vazhdimisht të ripyese, të riformulojë dhe të monitorojë vetveten në një botë që është gjithnjë në ndryshim.⁹

Në periudhën e Iluminizmit, u shënua një kthesë e rëndësishme, ku njeriu konsiderohej si subjekt racional dhe autonom, i aftë për të formësuar vetveten nëpërmjet arsyes dhe zgjedhjes. Kjo ide lindi në një kohë kur u dobësuan autoritetet tradicionale si feja dhe aristokracia, dhe individit filloi të shihej si qendër e vullnetit dhe kuptimit. Koncepti i subjektit autonom u përforcua më vonë nga romantizmi, i cili i dha përparësi ndjenjës, ndjeshmërisë dhe autenticitetit personal në ndërtimin e identitetit.

Në shekullin XX, me zhvillimet në psikologji dhe sociologji, identiteti u kuptua gjithnjë e më shumë si një konstrukt dinamik dhe i ndërvarur. Psikologët si Carl Rogers¹⁰ theksuan rëndësinë e përvojës subjektive dhe vetëvlerësimit në ndërtimin e një identiteti të shëndetshëm, ndërsa teoricienët si George Herbert Mead¹¹ theksuan rolin e ndërveprimit social dhe “vetes së reflektuar” - mënyrën se si ne ndërtojmë ndjenjën e vetes përmes syve të tjerëve. Kjo qasje sociologjike i jep rëndësi komunikimit simbolik dhe strukturave të diskursit si mjete përmes të cilave identiteti formohet dhe përforcohet.

Në epokën e globalizimit dhe digjitalizimit, identiteti ka hyrë në një fazë të re fluiditeti dhe pluraliteti. Në vend të një identiteti të unifikuar dhe të qëndrueshëm, individët shpesh zhvillojnë identitete të shumëfishta dhe të kontekstualizuara, të përcaktuara nga rolet që ata luajnë në sfera të ndryshme të jetës: profesionale, personale, online, kulturore apo politike. Ky pluralitet është një burim pasurie por edhe tensioni, pasi kërkon një ekuilibër të vazhdueshëm midis autenticitetit dhe përshtatjes. Nga perspektiva poststrukturaliste, autorë si Michel Foucault e problematizojnë identitetin si një konstrukt i ndërtuar nga diskurset dominuese dhe mekanizmat e pushtetit. Sipas Foucault, nuk ka një “vetvete” esenciale për t’u zbuluar, por vetëm forma të

⁹ Giddens, A. (1991). *Modernity and Self-Identity: Self and Society in the Late Modern Age*. Cambridge: Polity Press, f. 5.

¹⁰ Rogers, C. R. (1961). *On Becoming a Person: A Therapist's View of Psychotherapy*. Boston: Houghton Mifflin.

¹¹ Mead, G. H. (1934). *Mind, Self, and Society: From the Standpoint of a Social Behaviorist*. Chicago: University of Chicago Press.

ndryshme të subjektivizimit që janë produkt i marrëdhënieve shoqërore dhe institucioneve. Kjo qasje thekson rolin e gjuhës, normave dhe renditjes shoqërore në krijimin e subjektit dhe identitetit të tij.¹²

Në këtë drejtim, zhvillimi historik dhe teorik i konceptit të identitetit tregon se ai nuk është një element statik apo i dhënë natyrshëm, por një ndërtim kompleks që luhet ndërmjet të brendshmes dhe të jashtmes, ndërmjet individuale dhe kolektive, ndërmjet natyrës dhe kulturës. Për ta kuptuar në mënyrë të plotë, kërkohet një vështrim ndërdisiplinor që merr në konsideratë si dimensionet psikologjike të përvojës personale, ashtu edhe dimensionet sociologjike të strukturës dhe marrëdhënieve. Mund të themi se identiteti sot, në përkufizimin më të plotë, është një ndërthurje dinamike ndërmjet asaj që individ i ndjen për veten dhe asaj që tjerët presin ose i atribuojnë atij. Nuk është më një strukturë e fiksuar, por një rrjet i ndërlikuar përfaqësimesh, zgjedhjesh dhe ndërveprimesh - një projekt gjithnjë në ndërtim.

Epoka digjitale dhe rrjetet sociale si një kontekst i ri për identitetin

Identiteti, në epokën digjitale, nuk është një entitet i vetëm, por një proces i shumëfishtë, i ndikuar nga struktura psikologjike, ndërveprimet sociale dhe mediumet teknologjike. Ai është njëkohësisht një përpjekje për autenticitet dhe një akt performativ në sytë e të tjerëve. Në një kohë kur “të dukurit” shpesh ka më shumë peshë se “të qenët”, analiza e identitetit nuk mund të kuptohet pa përfshirë kontekstin mediatik dhe digjital ku ai zhvillohet.

Sipas Floridi, jemi tashmë në një fazë që ai e quan infosfera, ku ndarja ndërmjet “vetes reale” dhe “vetes digjitale” është zbehur në mënyrë të ndjeshme.¹³ Individu nuk është më vetëm përdorues i teknologjisë, por edhe produkt i saj. Jean Baudrillard e radikalizon këtë ide përmes konceptit të simulakrumit: në një botë të mbingarkuar nga imazhet, identiteti digjital nuk është më një pasqyrim i realitetit, por një konstrukt që mund ta zëvendësojë realitetin vetë. Ky simulim krijon një realitet të rremë, ku individ i jeton përmes “avatarëve” të vetes që shpesh janë më tërheqës dhe më të pranueshëm për të tjerët sesa vetë subjekti real.¹⁴ Në këtë mënyrë, të dukurit bëhet më i rëndësishëm se të qenurit - një zhvendosje që krijon tension të thellë brenda subjektit.

Sherry Turkle, në një qasje më bashkëkohore, thekson se teknologjia dhe rrjetet sociale e kanë shumëfishuar këtë “performancë identitare”. Ajo vë re se në epokën digjitale, individët zhvillojnë një “vetvete të fragmentuar”

¹² Foucault, M. (1982). The Subject and Power. In H. L. Dreyfus & P. Rabinow (Eds.), Michel Foucault: Beyond Structuralism and Hermeneutics (pp. 208–226). Chicago: University of Chicago Press.

¹³ Floridi, L. (2013). *The Ethics of Information*. Oxford: Oxford University Press.

¹⁴ Baudrillard, J. (1994). *Simulacra and Simulation* (S. F. Glaser, Trans.). Ann Arbor: University of Michigan Press.

(fragmented self) në platforma të ndryshme, ku secila pjesë pasqyron aspekte të veçanta të personalitetit ose të dëshiruarës.¹⁵ Kjo çon në atë që Floridi e përkufizon si një mbingarkesë informacionale identitare, ku vetja digjitale fillon të mos përputhet me vetveten reale dhe ndjenja e unitetit të brendshëm dobësohet. Fragmentimi i identitetit, siç paralajmëron edhe Bauman, nuk është më vetëm pasojë e kushteve të jetës moderne, por një strukturë jetese në vetvete - ku individit është i detyruar të përshtatet, të ndryshojë dhe të vetërregullojë identitetin e tij për të mbijetuar në një botë të lëngshme.

Sfidat e identitetit në epokën digjitale - Të jesh apo të dukesh?

Një nga sfidat më të mëdha të identitetit në epokën digjitale është tensioni mes autenticitetit dhe performancës së vetes në mjediset virtuale. Mediat sociale kanë krijuar një terren të ri ku individët nuk vetëm që prezantojnë veten, por e riformulojnë dhe menaxhojnë atë në mënyrë të vazhdueshme, në funksion të audiencës dhe normave të platformës. Siç vëren Goffman, çdo akt ndërveprues është një “performancë” që ndodh në skenën e jetës së përditshme - një koncept që merr një kuptim të thellë kur aplikohet në rrjetet sociale si Instagram apo TikTok, ku përdoruesit menaxhojnë me kujdes çdo imazh, çdo postim dhe çdo shenjë të pranisë së tyre.

Kjo ndarje mes vetes së përjetuar dhe asaj të prezantuar nuk është pa pasoja psikologjike. Hulumtimet tregojnë se përdorimi i shpeshtë i rrjeteve sociale është i lidhur me uljen e vetëvlerësimit, rritjen e ankthit social dhe ndjenjën e izolimit emocional¹⁶. Përmes platformave digjitale, individët ekspozohen vazhdimisht ndaj versioneve të kuruara të jetës së tjerëve, duke ndjerë se nuk janë “mjaftueshëm të mirë”, “të suksesshëm” apo “të dukshëm” në krahasim me të tjerët. Ky fenomen, që Baumeister e përshkruan si luftë për vetë-konfirmim, është thelluar në epokën digjitale ku çdo reagim - “like”, koment apo ndjekës - shërben si një njësi matëse për vlerën personale.¹⁷ Siç vëren edhe Boyd, të rinjtë përballen me një presion të madh për të mbajtur një imazh të pranueshëm publik, çka krijon stres të vazhdueshëm dhe kufizon hapësirën për autenticitet dhe vetë-reflektim të sinqertë. Ndërtimi i një identiteti të qëndrueshëm është i lidhur me mirëqenien psikologjike, ndërsa identitetet e fragmentuara dhe të paqëndrueshme mund të çojnë në kriza të thella ekzistenciale dhe izolim emocional.¹⁸

¹⁵ Turkle, S. (1995). *Life on the Screen: Identity in the Age of the Internet*. New York: Simon & Schuster.

¹⁶ Alfasi, Y. (2022). The relationship between social media use and self-esteem: The mediating role of social comparison and body image. *Current Psychology*, 41, 1365–1373.

¹⁷ Baumeister, R. F. (1986). *Public Self and Private Self*. New York: Springer-Verlag.

¹⁸ Harter, S. (2012). *The Construction of the Self: Developmental and Sociocultural Foundations* (2nd ed.). New York: Guilford Press.

Më tej, një aspekt kritik i formimit të identitetit në rrjetet sociale është koncepti i “Vetes së pasqyruar” (Looking-Glass Self), i propozuar nga Charles Horton Cooley. Sipas kësaj teorie, individët e ndërtojnë identitetin e tyre duke parë sesi të tjerët i perceptojnë dhe duke u bazuar në reagimet e tyre. Rrjetet sociale e zmadhojnë këtë proces, pasi çdo postim, koment ose pëlqim mund të përforcojë ose të ndryshojë vetë-imazhin e dikujt. Përmes kësaj, individët adoptojnë një pasqyrë të ndërlikuar të vetvetes, që është formuar nga perceptimet e të tjerëve për ta, si dhe përvoja e tyre personale. Ky koncept është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin e rrjeteve sociale, ku ndërveprimet dhe reagimet e përdoruesve janë të shpeshta dhe të ekspozuara në mënyrë publike.¹⁹

Në një realitet ku ndërveprimet ndodhin gjithnjë e më shpesh në sferën virtuale, jo vetëm që identiteti fragmentohet, por ai shpesh i nënshtrohet një lloj kolonizimi teknologjik. Platforma të mëdha si Instagram, TikTok apo LinkedIn nuk janë më thjesht hapësira për ndarje përmbajtjesh, por mjete të fuqishme për ndërtimin dhe shitjen e një identiteti-markë. Ky proces i personal branding-ut, i cili në teori fuqizon subjektin, në praktikë mund ta reduktojë individin në një produkt që duhet të jetë gjithnjë i konsumueshëm, tërheqës dhe në përditësim të vazhdueshëm. Në këtë drejtim, Byung-Chul Han flet për një “shoqëri të transparencës” ku gjithçka duhet të jetë e dukshme, e matshme dhe e performuar - dhe vetja nuk është më një subjekt i fshehtë e i thellë, por një objekt për konsum publik.²⁰

Ky presion për të qenë “i dukshëm” dhe “i përkryer” çon në një formë të re të tëhuajëzimit (alienation), ku individi fillon të jetojë në funksion të imagjinatës së audiencës, duke krijuar një version të vetes që është i orientuar më shumë nga pritshmëritë e jashtme sesa nga ndjeshmëria e brendshme. Ky lloj vetë-monitorimi dhe vetë-rregullimi i vazhdueshëm, sipas teorisë së Michel Foucault mbi “qytetarin e disiplinuar”, përbën një formë të re të kontrollit shoqëror ku pushteti nuk është më i jashtëm, por i brendësuar - individi bëhet mbikëqyrësi i vetvetes në emër të normave kulturore të digjitalitetit.²¹

Ky tension midis vetes së vërtetë dhe vetes së kuruar mund të çojë në lodhje identitare - një gjendje psikologjike ku subjekti humbet ndjeshmërinë ndaj asaj që është me të vërtetë, për shkak të presionit të përhershëm për të qenë “diçka”. Në këtë kontekst, mungesa e koherencës së identitetit lidhet me rritjen e çrregullimeve të humorit, krizave të identitetit dhe ndjesisë së zbrazëtisë.²²

¹⁹ Cooley, C. H. (1902). *Human Nature and the Social Order*. New York: Charles Scribner's Sons.

²⁰ Han, B.-C. (2015). *The Transparency Society* (E. Butler, Trans.). Stanford, CA: Stanford University Press.

²¹ Foucault, M. (1977). *Discipline and Punish: The Birth of the Prison* (A. Sheridan, Trans.). New York: Pantheon Books.

²² Harter, S. (2012). *The Construction of the Self: Developmental and Sociocultural Foundations* (2nd ed.). New York: Guilford Press.

Në këtë drejtim, edukimi digjital dhe psikologjia sociale mund të luajnë një rol kyç në ndërtimin e rezistencës identitare, duke ndihmuar individët të dallojnë mes vetes reale dhe vetes së projektuar, mes realitetit dhe iluzionit të rrjeteve. Vetëm nëpërmjet një ndërgjegjësimi të tillë mund të shprejsojmë për një formë më të qëndrueshme, autentike dhe të qëllimshme të të qenit në epokën digjitale.

Conclusion

The digital era has profoundly reshaped the concept of identity, transforming it from a stable, socially rooted construct into a fluid, performative, and highly mediated process. In the context of social media and digital technologies, identity is no longer merely discovered but actively constructed, curated, and displayed in response to shifting audiences and technological frameworks. While this evolution offers unprecedented opportunities for self-expression and personal reinvention, it also introduces serious psychological and social challenges, including identity fragmentation, performance pressure, and diminished authenticity.

The tension between “being” and “appearing” lies at the heart of the digital identity crisis. Individuals today are not only asked to be themselves but to constantly perform a version of themselves that aligns with cultural expectations, platform algorithms, and social visibility. This continuous performance, while empowering in some respects, often leads to anxiety, lowered self-esteem, and a loss of coherence in one’s personal narrative.

In light of these challenges, this paper calls for a renewed emphasis on digital self-awareness, ethical media engagement, and critical education about identity formation in online environments. Future research must further explore how emerging technologies, cultural dynamics, and generational experiences intersect in shaping digital identities, and how individuals can navigate these complexities while preserving a sense of authenticity and psychological well-being.

Recensentë:

Doc. dr. Fatima Salifoska

Dr. Teuta Agai Demjaha

Bibliografia

Abidin, C. (2016). “Aren’t These Just Young, Rich Women Doing Vain Things Online?”: Influencer selfies as subversive frivolity. *Social Media + Society*, 2(2), 1–17.

<https://doi.org/10.1177/2056305116641342>

- Alfasi, Y. (2022). Self-Esteem and Real Self and False Self Presentation on Facebook Among Emerging Adults: The Moderating Role of Social Anxiety. *Current Psychology*. <https://doi.org/10.1007/s12144-022-03402-5>
- Baudrillard, J. (1994). *Simulacra and Simulation* (S. F. Glaser, Trans.). University of Michigan Press.
- Bauman, Z. (2000). *Liquid Modernity*. Polity Press.
- Baumeister, R. F. (1986). *Public Self and Private Self*. Springer-Verlag.
- boyd, d. (2014). *It's Complicated: The Social Lives of Networked Teens*. Yale University Press.
- Cooley, C. H. (1902). *Human Nature and the Social Order*. Charles Scribner's Sons.
- Floridi, L. (2013). *The Ethics of Information*. Oxford University Press.
- Foucault, M. (1977). *Discipline and Punish: The Birth of the Prison* (A. Sheridan, Trans.). Pantheon Books.
- Foucault, M. (1982). The Subject and Power. In H. L. Dreyfus & P. Rabinow (Eds.), *Michel Foucault: Beyond Structuralism and Hermeneutics* (pp. 208–226). University of Chicago Press.
- Giddens, A. (1991). *Modernity and Self-Identity: Self and Society in the Late Modern Age*. Polity Press.
- Goffman, E. (1959). *The Presentation of Self in Everyday Life*. Anchor Books.
- Han, B.-C. (2015). *The Transparency Society* (E. Butler, Trans.). Stanford University Press.
- Harter, S. (2012). *The Construction of the Self: Developmental and Sociocultural Foundations* (2nd ed.). Guilford Press.
- Mead, G. H. (1934). *Mind, Self, and Society: From the Standpoint of a Social Behaviorist*. University of Chicago Press.
- Pariser, E. (2011). *The Filter Bubble: What the Internet Is Hiding from You*. Penguin Books.
- Rettberg, J. W. (2014). *Seeing Ourselves Through Technology: How We Use Selfies, Blogs and Wearable Devices to See and Shape Ourselves*. Palgrave Macmillan.
- Rogers, C. R. (1961). *On Becoming a Person: A Therapist's View of Psychotherapy*. Houghton Mifflin.
- Turkle, S. (1995). *Life on the Screen: Identity in the Age of the Internet*. Simon & Schuster.
- Turkle, S. (2011). *Alone Together: Why We Expect More from Technology and Less from Each Other*. Basic Books.
- Zhao, S., Grasmuck, S., & Martin, J. (2008). Identity construction on Facebook: Digital empowerment in anchored relationships. *Computers in Human Behavior*, 24(5), 1816–1836.